



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË**  
**DEGA VENDORE VLORE**

**NOTER ARBEN P. NDINI**  
**ADRESA Lagjja "ILIRIA", Rr.**  
**"ANTIPATREA", NR. 35/3.**  
**TEL: 0684315636**

# **KONTRATË DHURIMI PASURI E**

# **LUAJTSHME**

**(AKSIONE)**

**Nr. repertori: 189**

**Nr. koleksioni: 105**

**Berat më 13/03/2025**

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 124/2024, datë 19/12/2024 "Për mbrojtjen e të dhënave personale"
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar



A2025061930011241111





A2025061930011241111



**KONTRATË DHURIMI**  
(Për kuotat e kapitalit të shoqërsë tregëtare)

Sot më datë 13.03.2025, para meje Noterit publik të qytetit të Beratit, Arben Petro Ndini, anëtar i Dhomës Kombëtare të Noterisë, me zyrë në qytetin e Beratit, në adresën: lagjia "Iliria" (ish 10 Korriku, ose Uzgur), pranë Gjykatës, rruga "Antipatrea" nr. 35/3, u paraqitën personalisht:

**DHURUES:**

Davide Lo Conte, me atësi Gabriele me amësi Maria, i lindur më 19.08.1970, në Ariano Irpino (AV), Itali (ITA) dhe banues në Linzë të Tiranës, me numër personal H03818003N, me numër 261154 të Lejes së Qëndrimit dhe nr. 838681872 të Letërnjoftimit, i cili me deklarohet në gjuhën shqipe.

**PRANUES DHURIMI:**

Enkelejda Gojka, me atësi Ismail dhe amësi Mineko, e lindur më 26/01/1972, në Mbrakull, Berat dhe banuese në 5001 BLV. Republika nr. 20, Bashkia Berat, me shtetësi shqipëtare, me gjendje civile e shkurorëzuar, me numër personal H25126058V, me numër 033135963 të Letërnjoftimit.

Flamur Dervishanji, me atësi Xhevit dhe amësi Nadire, i lindur më 15/03/1959, në Bistrovicë, Berat dhe banues në 5007, Pashalli, nr. 56, Ura Vajgurore, Bashkia Dimal, me shtetësi shqipëtare, me gjendje civile i martuar, me numër personal F90315002W, me numër 039320896 të Letërnjoftimit.

Palët madhorë, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, me identitetin e të cileve u njoha sipas ligjit, të cilet me vullnetin e tyre të lirë dhe të pa vesuar pohojnë para meje Noterit publik lidhjen e kësaj kontrate dhurimi të pasurisë së paluajtshme, në bazë të neneve 79 e vijues, 761 e vijues të Kodit Civil dhe të Ligji nr. 110, datë 20.12.2018 "Për Noterinë", si më poshtë vijon:

**Objekti i kontratës**

Duke pasur parasysh ekstraktin e përpiluar dhe të lëshuar nga Qendra Kombetare e Biznesit, objekt i kësaj kontrate është dhurimi i kuotave të kapitaleve të shoqërisë në pronësi të dhuruesit e gjendur e regjistruar me të dhënat:

Shoqëria tregëtare private "RISTORO" sh.p.k. me numër unik identifikimi të subjektit M52516002R, me seli në lagjen "30 Vjetori" të Beratit.

Për këtë pronësi dhuruesi zotëron Ekstraktin nga Regjistrit Tregëtar të lëshuar më datën 13.03.2025.

Kapitalet e kësaj shoqërie, dhuruesi i zotëron në tërësi, në masën 100%.

**Të drejtat, detyrimet dhe pohimet e dhuruesit**

Për të gjithë kapitalin e kësaj shoqërie të më sipër treguar në këtë kontratë, dhuruesi z. Davide Lo Conte, me vullnetin e tij të lirë pohon se i dhuron pranuesve të dhurimit zj. Enkelejda Gojka dhe z. Flamur Dervishanji pa kusht, pa kundërshtpërblim, pa interes dhe përfundimisht:

Enkelejda Gojka i dhurohet 33,333% e gjithë kuotave të kapitalit të shoqërisë.



Flamur Dervishanji i dhurohet 33,333% e gjithë kuotave të kapitalit të shoqërisë.  
Dhuruesi garanton Pranuesit e Dhurimit:  
Për rregullsinë e dokumentacionit të shoqërisë dhe të kapitaleve të saj.  
Se të gjithë këtë shoqëri dhe kapitalet e saj nuk i ka vënë si garanci për ndonjë detyrim financiar dhe se kjo shoqëri është e lirë nga çdo barrë dhe hipotekë.  
Se kapitalet në shoqërinë, objekt i kësaj kontrate dhurimi, nuk janë përfshirë në ndonjë konflikt gjyqësor për çdo lloj konflikti për fitim pronësie nga të tretët.  
Se dokumentacioni i këtyre kapitaleve të shoqërisë është origjinal, i pa fallcifikuar, ligjor dhe është marë në përputhje të plotë me procedurat ligjore në fuqi.  
Se nuk kanë asnjë dijeni për pretendime pronësie të të tretëve mbi këtë shoqëri dhe kapitalet e saj.

Të drejtat, detyrimet dhe pohimet e pranuesve të dhurimit  
Pranuesit e Dhurimit pohojnë se,  
Pranojnë këtë dhurim plotësisht dhe pa asnjë vërejtje.

Dorëzimi i pronës  
Palët pohojnë se dorëzimi i kapitaleve të kësaj shoqërie është kryer tek pranuesi i dhurimit jashtë kësaj zyre noteriale dhe para lidhjes së kësaj kontrate.

Kalimi i pronësisë  
Kalimi i pronësisë së kuotave të sipërsënuara në këtë kontratë dhurimi, bëhet nga dhuruesi tek pranuesit e dhurimit menjëherë në çastin e lidhjes së kësaj kontrate.  
Me nënshkrimin e kësaj kontrate dhuruesi i kalon të drejtën e tij të pronësisë pranuesve të dhurimit, të kuotave të treguara si më sipër duke humbur vet të gjitha të drejtat e pronësisë 66,666 % të kuotave të kapitalit të shoqërisë.  
Gjithashtu me nënshkrimin e kësaj kontrate zj. Enkelejda Gojka dhe zj. Flamur Dervishanji fitojnë të drejtat e pronësisë duke u bërë pronarë me të drejta të plota dhe pa kushte mbi kuotat e kapitalit të shoqërisë tregëtare private "RISTORO" sh.p.k. në masën:

Enkelejda Gojka në masën 33,333% e gjithë kuotave të kapitalit të shoqërisë.  
Flamur Dervishanji në masën 33,333% e gjithë kuotave të kapitalit të shoqërisë.  
Pjesa tjetër e kuotave të kapitalit të shoqërisë "RISTORO" sh.p.k. në masën 33,333% mbeten të pa prekura në pronësi të ortakut Davide Lo Conte.

Zgjidhja dhe ndryshime në kontratë  
Kjo kontratë mund të ndryshojë ose të zgjidhet:  
Me pëlqimin e përbashkët të palëve.  
Me vendim gjyqësor të formës së prerë.  
Asnjë nga palët nuk ka të drejtë të zgjidhë apo të ndryshojë këtë kontratë në mënyrë të njëanshme, por në çdo rast me zgjidhjen e kësaj kontrate palëve u lind detyrimi ligjor të kthehen në gjendjen e mëparshme.

Të fundit  
Palët marrin përsipër detyrimin e respektimit me korrektësi të kësaj kontrate. Për çdo mosmarëveshje të lindur pas saj, palët do të bisedojnë drejt për drejt me njëra – tjetrën. Nëse nuk arrihet mirëkuptimi secila nga palët rezervon të drejtën t'i drejtohet Gjykatës kompetente. Për çdo pretendim të palëve, të pa parashikuar në këtë kontratë do të zbatohen dispozitat e K. Civil dhe të Statutit të shoqërisë.



A2025061930011241111

Nga unë Noteri palëve iu tregua detyrimi ligjor i regjistrimit të kësaj kontrate në afatin ligjor 30 (tridhjetë) ditor në Qendrën Kombëtare të Biznesit, i cili fillona nga çasti i nënshkrimit të këtij akti.

Ruajtja dhe përpunimi i të dhënave personale të subjekteve të këtij akti, kryhet në zbatim të Ligjit nr. 124/2024, datë 19.12.2024, "Për mbrojtjen e të dhënave Personale". Bazuar në këtë ligj për realizimin e kësaj kontrate, palët pohojnë se lejojnë që noteri në çdo kohë, të marrë në dispozicion çdo të dhënë të tyre ligjore, financiare, personale dhe familjare si dhe, të paraqesë në çdo kohë tek institucionet përkatëse ligjore apo financiare të dhëna apo dokumente të kërkuara prej tyre në realizimin e qëllimeve ligjore.

Kjo kontratë u shkrua dhe iu lexua palëve nga unë Noteri publik si dhe, u lexua edhe nga vetë palët, të cilët pranuan me zë se u njohën me përmbajtjen e kontratës dhe se janë dakort me të. Pasi u pa se kontrata ishte shkruar drejt dhe në përputhje të plotë me vullnetin e lirë të palëve, u nënshkrua rregullisht prej tyre këtu më poshtë pa verejtje.

Kontrata u shkrua në katër kopje të barazvlershme.

PALËT

NOTERI

DAVIDE LOCONTE

Enkelejda Gojka

FLAMUR DERVISHAMP

#14

